



Vlaanderen
is divers

REGULLORE E TARIFAVE

TË KURSIT DHE TESTEVE ORIENTIM NË SHOQËRI

1 SHTATOR 2023

AGENTSCHAP
INTEGRATIE &
INBURGERING

Amal



Në këtë regullorë ti gjen marrëveshjet mbi pagesën e kursit Orientim në Shoqëri (MO) dhe të testeve MO¹:

- Testi i përjashtimit nga detyrimi për të ndjekur MO
- Kursi MO
- Testi pas kursit MO

1 Sa kushtojnë kursi MO dhe testet MO? ²

Ti paguan një çmim fiks.

- **90 euro për testin e përjashtimit nga detyrimi për të ndjekur MO**

Testin e përjashtimit nga detyrimi për të ndjekur MO mund t'a bësh vetëm **një herë** para se ti nënshkruan kontratën e integritimit.

- **90 euro për kursin MO**

Duhet t'a ndjekësh përsëri kursin MO? Atëherë ti **nuk** duhet të paguash përsëri.

- **90 euro për test MO pas kursit**

Duhet t'a bësh përsëri testin MO? Atëherë ti duhet të paguash **përsëri** 90 euro.

2 Në cilat situata nuk duhet të paguash?

- Ti je në një nga këto situata:
 - o Ti je i/e regjistruar në Regjistrin Kombëtar në territorin dy-gjuhësh Brussel-Hoofdstad (Bruxelles-Kryeqytet).
 - o Ti nuk ke diplomë të arsimit të mesëm **dhe** ti je i/e regjistruar në një kurs/trajnim:
 - geletterheidsmodules Nederlands dhe Leren leren (modul i alfabetizimit holandisht dhe Mësoj si si të mësoj)
 - 'Regie over het Eigen Leren' (Regji mbi mënyrën se si mëson)
 - në fushat e mësimin të edukimit bazë, të organizuar nga Ligo
 - në fushat e studimit 'aanvullende algemene vorming' (formim i përgjithshëm plotësues), ose 'algemene vorming' (formim i përgjithshëm);
 - o Ti merr asistencë financiare ('leefloon' ose 'inkomen via maatschappelijke dienstverlening'), **ose** ti je në ngarkim të dikujt që merr asistencë financiare ('leefloon' ose 'inkomen via maatschappelijke dienstverlening');
 - o Ti je një i/e burgosur³;
 - o Ti je një kërkues/-e pune **dhe** ti ndjek një kurs/trajnim në kuadër të një trajekti për punën⁴;
 - o Ti je një i/e papunë, me detyrim i/e regjistruar për të kërkuar punë **dhe** në momentin e regjistrimit ti nuk ke të drejtë të marrësh pagesë aktivizimi (inschakelingsuitkering);
 - o Ti je i/e regjistruar për një kurs/trajnim tek Ligo, Qendrat e Edukimit Bazë (CBE). Një Qendër për Arsimimin e të Rriturve (CVO)⁵ organizon kursin/trajnimin.
 - o Ti je më i ri/e re se 18 vjeç/-e ose ti bëhesh 18 vjeç/-e në shtator, tetor, nëntor, dhjetor⁶

¹ Artikel 78/1 besluit van 29 januari 2016 houdende de uitvoering van het decreet van 7 juni 2013 betreffende het Vlaamse Integratie- en Inburgeringsbeleid bepaalt dat wie vóór 1 september 2023 een inburgeringscontract gesloten heeft geen retributie betaalt voor de cursus en de test van het vormingspakket maatschappelijke oriëntatie.

² Artikel 30 van het decreet van 7 juni 2013 betreffende het Vlaamse Integratie- en Inburgeringsbeleid en artikel 27/3 van het besluit van 29 januari 2016 houdende de uitvoering van het decreet van 7 juni 2013 betreffende het Vlaamse Integratie- en Inburgeringsbeleid.

³ Gedetineerd zoals bepaald in artikel 2, 16° bis van het decreet van 15 juni 2007 betreffende het volwassenenonderwijs

⁴ Werkzoekend zoals bepaald in artikel 2, 47° bis van het decreet van 15 juni 2007 betreffende het volwassenenonderwijs

⁵ Opleiding zoals bedoeld in artikel 64bis van het decreet van 15 juni 2007 betreffende het volwassenenonderwijs

⁶ Minderjarige inburgeraar als vermeld in artikel 26, § 1, eerste lid, 3° van het decreet van 7 juni 2013 betreffende het Vlaamse Integratie en Inburgeringsbeleid

- Ti e ke marrë tashmë një **vërtetim integrimi** nga Komuniteti Gjermanishtfolës, Komuniteti Frëngjishtfolës, Komisioni i Komunitetit Frëngjishtfolës of Komisioni i Komunitetit të Përbashkët:
 - o Ti nuk duhet të paguash për testin e përjashtimit nga detyrimi për të ndjekur MO

3 Kur duhet të paguash?

Ti paguan në momentin e regjistrimit në një kurs MO dhe/ose një test MO.

4 Si mund të paguash?

Ti paguan në mënyrë dixhitale me një kod QR ose një link pagese.

Nuk mund të paguash në mënyrë dixhitale? Atëherë një bashkëpunëtor/punonjës të informon se si mund të paguash.

5 Çfarë ndodh nëse ke probleme financiare dhe nuk mund të paguash menjëherë?

Ti duhet të diskutosh mbi mundësitë me një bashkëpunëtor/punonjës.

Ty mund të të jepet shtyerje e pagesës.

- Ti bën marrëveshje mbi pagesën.

Nuk i respekton marrëveshjet e bëra për pagesën? Atëherë ka mundësi të ketë shpenzime shtesë.

- Ti merr një letër rekomande/me porosi. Kjo letër është një kujtesë për të paguar.

Edhe pas kësaj kujtese për të paguar nuk paguan?

- Agjencia ia kalon dosjen tënde Shërbimit Flaman të Taksave (VLABEL). Kjo organizatë mund të vendosë të kërkojë pagesën me detyrim. Kjo gjë kushton para shtesë. Këto para shtesë duhet t'i paguash vetë.

6 Çfarë ndodh nëse ti refuzon për të paguar?

- Ti nuk dëshiron të paguash në fillim të kursit ose të testit **dhe**
- ti je **i/e detyruar** për të ndjekur trajektin e integritit?

Agjencia ia kalon dosjen tënde nëpunësit të kontrollit të zbatimit të rregullave. Ky person vendos mbi ndëshkime/gjoba⁷.

- Ty mund të të jepet një gjobë.
- Ti vazhdon të jesh i/e detyruar të paguash.
- Ti vazhdon të jesh i/e detyruar të ndjekësh trajektin.

Të është dhënë shtyerje e pagesës për arsye të problemeve financiarë? Atëherë nuk të jepet ndëshkim/gjobë.

7 Kur të jepet vërtetimi yt i integritit?

Ty të jepet vërtetimi yt i integritit nëse:

- Ti i ke arritur të gjithë qëllimet

⁷ Sancties zoals vermeld artikel 39 van het decreet van 7 juni 2013 betreffende het Vlaamse Integratie- en Inburgeringsbeleid en artikel 33 van het besluit van 29 januari 2016 houdende de uitvoering van het decreet van 7 juni 2013 betreffende het Vlaamse Integratie- en Inburgeringsbeleid.

- Ti i ke paguar tarifat MO.

8 A mund të të kthehen paratë tuaja?

Jo. Kthimi i parave (rimbursimi) nuk është i mundur.

9 Ke ndonjë sugjerim, shënim apo ankesë?

Bashkëpunëtorët/punonjësit tanë të ndihmojnë me dëshirë.

Ose shko tek faqja jonë në internet:

- Voor Atlas: <https://www.atlas-antwerpen.be/nl/contact/klachtenformulier>
- Voor Amal: <https://www.amal.gent/contact>
- Voor het Vlaams Agentschap Integratie en Inburgering: <https://www.integratie-inburgering.be/nl/contact/heb-je-een-klacht-of-wil-je-beroep-aantekenen>